



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201701341/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për lëshimin e dokumentave të pronësisë në favor të shtetas N.L për pasurinë e transkriptuar në favor të F.L me Nr.265, (vol 1, për fshatin), datë 01.09.1992 të rregjistrimit hipotekor*

Drejtuar : Rregjistruesit të Zyrës Vendore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme,

BERAT

Për dijëni : **Ministrisë së Drejtësisë**

Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Rregjistrimit të pasurive të Paluajtshme
Z.Blerina Doracaj

N.L
Adresa:

BERAT

Z.Rregjistrues!

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetas N.L, në të cilën prezantohet shqetësimi për moslëshimin nga ana juaj të dokumentacionit të pronësisë për pasurinë e regjistruar me nr.265, Vol 1, (për fshatin), datë 01.09.1992, të rregjistrimit hipotekor, në emër të F.R..L.

Në përgjigje të kërkesës (aplikimit) Nr.7949, datë 21.09.2017, për pajisje me dokument pronësie për pasurinë e lartpërmendur, ju z.Regjistrues, me Akt Verifikimin Nr.559, Datë 06.10.2017, drejtuar subjektit F.L., shpreheni se, për të vazhduar procedurën për dhënien e shërbimit të kërkuar prej subjekti pronar, duhen plotësuar nga ana e tij dokumentacioni që ju administroni, dhe se ky dokumentacion duhet dorëzuar në sportelin e ZVRPP, Berat. Më tej, në Akt Verifikimit Nr.559, Datë 06.10.2017, ju shpreheni se;

- *"Dokumentet e privatizimit që ndodhen në referencën e rregjistrimit janë fotokopje e noterizuar (V.pronësie, K.Shitje privatizimi nga Agjensia + akt dorëzim)*

- *Mungon kontrata e shitjes për truallin, është regjistruar në bazë të vërtetimit të pronësisë i cili ndodhet në referenc fotokopje e noterizuar”.*

Kërkesat tuaja, z.Regjistruar, sikurse prezantuar në Akt Verifikimin Nr.559, Datë 06.10.2017, janë të pabazuara në ligj. Qëndrimi i shfaqur nga ana juaj është shprehje e paditurisë lidhur me vlefshmërinë e akteve. nenit 39/f i Ligjit nr.7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, parashikon se, noteri ka kompetencë midisë të tjerave, të vërtetojë, se, kopjet ose shkurtimeve e dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga të interesuarit. Në këtë situatë ligjore, nuk ka pasur dhe nuk ka shkak ligjor për kërkimin nga ana juaj të dokumentacionit origjinal të pronësisë. Ndaj organit shtetëror apo noterit, që ka mundësuar lidhjen e kontratës me subjektin pronar, ju mund të kërkoni konfirmimin e vërtetësisë së titullit të pronësisë, duke mos cënuar të drejtën e pronarit për disponim mbi pasurinë e tij. Për pasurinë e regjistruar me nr.265, Vol 1, (për fshatin), datë 01.09.1992, të regjistrit hipotekor, në emër të F.R.L., rezulton se, ZVRPP, Berat, ka lëshuar rregullisht dokumentacion pronësie pronarit sipas Vërtetimit “Nga dokumentet hipotekor”, datë 27.09.2011, për pasurinë në regjistrin hipotekor nr.15, Fq 237, datë 19.03.2002, apo Vërtetim “Nga dokumentet hipotekor”, datë 27.09.2011, për pasurinë e regjistruar me .r.13/350, Fq 17, Vol 14, ZK 8501, datë 19.03.2002.

Ju sjellim në vëmendje se, neni 196 i Kodit Civil, parashikon detyrimin e gjykatës, noterit, përmbaresit gjyqësor dhe organeve të tjera shtetërore për dërgimit për regjistrim të titullit të pronësisë, dhe se parashikimi i kryer në nenin 20/e të Ligjit nr.33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, ju lejon të verifikoni të dhënat në dokumentacionet që ju administroni, dhe jo të kushtëzoni pa shkak, dhënien e shërbimit të kërkuar prej subjektit F.L.

Veprimtaria e derisotme e kryer organit që ju përfaqësoni, për dhënien e shërbimit të kërkuar prej ankuesit, e vlerësojmë në çënim të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor sikurse sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë apo Nenin 6/1 të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, miratuar me Ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, “Për ratifikimin e Konvetës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, prej Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, duhet kuptuar se, veprimtaria juaj në rastin e prezantuar, është kryer në kundërshtim me parimin e sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Nenin 1 “Mrojtja e pronës”, Protokollin nr.1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, miratuar me Ligjin nr 8137, datë 31.07.1996, prej Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

Për të gjitha këto arsye, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata Publike”, si dhe Nenit 21/b, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave të menjëhershme për lëshimin e dokumentave të pronësisë shtetasit F.L., për pasurinë e regjistruar me Nr.265, Datë 01.09.1992, të rregjistrit hipotekor apo Nr.15, 19.03.2002, dhe nr.13/350, Fq 17, Vol 14, ZK 8501, datë 19.03.2002.

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë;

Kopje të Akt Verifikimit nr.559, datë 06.10.2017, drejtuar prej ZVRPP, Berat, subjektit F.L.

Kopje të Vërtetimit “Nga dokumentet hipotekor”, datë 27.09.2011, për pasurinë në rregjistrin hipotekor nr.15, Fq 237, datë 19.03.2002,

Kopje të Vërtetimit “Nga dokumentet hipotekor”, datë 27.09.2011, për pasurinë e rregjistruar me nr.13/350, Fq 17, Vol 14, ZK 8501, datë 19.03.2002.

KOMISIONERI

Arben SHKEMBI